



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 15 qershor 2011, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Aurora Bakalli, Gëzim Kelmendi dhe Nazane Breca.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Shefki Kastrati- NDI, Ukë Gashi- Presidenca e Kosovës, Shkëlzen Lushaku- KDI.

Të njëjtën e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 08.06.2011;**
- 3. Shqyrtimi i amendamenteve të Projektligjit për Këshillin Ekonomik-Social;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 08.06. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e datës 8 qershor 2011.

3. Shqyrtimi i amendamenteve të Projektligjit për Këshillin Ekonomik Social

Fikrim Damka- Grupi punues i ka miratuar amendamentet e këtij projektligji. Ftoj kryesuesen e këtij grupi që t'i paraqes para Komisionit amendamentet.

Flora Brovina- Tha se kemi bërë një punë të mirë si grup. Kemi mbajtur edhe një tryezë, ku palët e interesuara kanë shprehur qëndrimet e tyre. Komisionit i paraqesim këto amendamente:

Amendament 1

Në tërë tekstin e projektligjit fjala: „Organizatat e punëmarrësve” zëvendësohet me :„Organizatat e të punësuarve “

Amendament 2

Në nenin 7, paragrafin 1, pika 1.1, pas fjalës „, librezës “ shtohet fjala „së anëtarësisë”.

Amendament 3

Në nenin 7, pas paragrafit 4, shtohet paragraf i ri si vijon: „ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në afat prej 6 muajsh, pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, nxjerr akt nënligjor për përbërjen e komisionit përzgjedhës për anëtarët e KSE- it, nga organizatat e të punësuarve dhe të punëdhënësve.

Amendament 4

Në nenin 9, paragrafin 1, nënparagrafi 1.5, pas fjalës „pagat “ shtohet fjala „pagën minimale “

Amendament 5

Në titullin e nenit 10, pas fjalës „ vlerësimet” shtohet „, dhe rekomandimet “ dhe në paragrafin 2, fshihet „, apo” zëvendësohet me „, dhe”.

Amendament 6

Në neni 12, paragrafi 6, fjalia „, eprorët e tyre “ fshihet dhe zëvendësohet me „, udhëheqësit e tyre” dhe fjalia në vazhdim fshihet.

Amendament 7

Në titullin e nenit 13, dhe në tërë tekstin e Projektligjit, pas fjalës „grupet negociatore” të shtohet fjala „, ad – hoc “.

Amendament 8

Në nenin 13 , paragrafin 1 , fshihet fjala „,politikat” dhe zëvendësohet me „,çështjet “ .

Amendament 9

Në nenin 15, paragrafin 1, nënparagrafi 1.2, pas fjalës „Kontributet “ shtohet fjala „,vullnetare “.

Amendament 10

Në nenin 15, paragrafët 5 dhe 6, në fund të paragrafëve fshihet fjala„, paushall”.

Amendament 11

Në nenin 15, paragrafi 5, nënparagrafi 5.1, fshihet „,15%” dhe zëvendësohet me „,10% “.

Amendament 12

Në nenin 15, paragrafi 5, nënparagrafi 5.2 fshihet fjalia: „ Nuk është i pranishëm, së paku, në 3 (tre) takime të caktuara nga KES –i ‘’ dhe zëvendësohet me: „ nuk merr pjesë në një takim të KES- it.

Amendament 13

Në nenin 15, paragrafi 6, nënparagrafi 6.1, fshihet „15%’’ dhe zëvendësohet me „10% ‘’.

Amendament 14

Në nenin 15, paragrafi 8 , në fund të paragrafit fshihet fjala „ nënligjore”.

Amendament 15

Në nenin 17, paragrafi 1 riformulohet „ Vendimet e KES –it miratohen me 2/3 e votave të anëtarëve të përhershëm të KES- it.

Amendament 16

Në nenin 17, paragrafi 4, fshihet fjala „ndaras’’ dhe zëvendësohet: „ Me votim të fshehtë’’.

Amendament 17

Në nenin 17, paragrafi 5, fshihet fjala „ së bashku ‘’ dhe zëvendësohet: „Me votim të hapur’’.

Amendament 18

Në nenin 17, fshihet paragrafi 6.

Amendament 19

Në nenin 18, paragrafi 1, fshihet „2 (dy)’’.

Amendament 20

Në nenin 19 , paragrafi 2, në fund të paragrafit shtohet fjalia: „ i cili pasohet në mënyrë rotative nga përfaqësuesi i punëdhënësve dhe nga përfaqësuesi i të punësuarve.

Amendament 2

Në neni 21, paragrafin 3 , pas nënpragrafit 3.5 shtohet nënparagraf i ri: „ 3.6. Në rast vdekje”.

Komisioni njëzëri votoi amendamentet e propozuara nga grupi punues.

4. Të ndryshme

Fikrim Damka- Tha se listën e ekspertëve nuk e kemi votuar ende. A ka dikush ndonjë propozim?

Nazane Breca- Tha se propozon Valdet Hashanin.

Aurora Bakalli- Tha se propozon Sami Rexhepin.

Time Kadriaj- Tha se propozon: Luan Jahën, Talat Gjinollin dhe Tefik Bekteshin.

Pas propozimeve, Komisioni miratoi listën e ekspertëve.

Fikrim Damka- Tha se, sipas planit, sot është dashur ta takojmë ministrin Rashiq. Javën e ardhshme duhet ta takojmë ministrin.

Flora Brovina- Tha se takimi me ministrin do të ishte shumë me rëndësi, sepse duhet ta përshpejtojmë Projektligjin për invalidët e luftës. I kemi invalidët dhe veteranët e luftës në grevë dhe duhet të bëjmë një zgjidhje sa më shpejt.
Dje u mbajt një tryezë për zbatimin e Ligjit të Punës. Propozoj ta monitorojmë zbatimin e këtij ligji.

Time Kadriaj- Kemi pasur kërkesë nga kryetari i parlamentit që sa më shpejt të bëhet amendamenti i ligjeve dhe të sillen për miratim.

Gëzim Kelmendi- Tha se i ka sjellë dy rekomandime lidhur me akcizën për duhanin. E kemi vlerën e akcizës më të ultën në rajon dhe Evropë. Propozoj që akciza për duhanin të rritet për 10 euro dhe nga kjo 2 euro të shkojnë për Ministrinë e Shëndetësisë.

Fikrim Damka- Grumbullimi i akcizës për duhanin është paraparë me dy projektligjet: për shëndetësi dhe për sigurime shëndetësore.

Bahri Thaçi- Tha se duhet të analizohet lartësia e akcizës krahasuar me të ardhurat që i kemi.

Time Kadriaj- Tha se duhet të kontaktohen organizatat e huaja mbështetëse të Kuvendit që të na mbështesin më shumë, sepse jemi të anashkaluar si Komision.

Salihe Mustafa- Tha se ne e kemi të angazhuar një ekspert, për të cilin është duke na mbështetur edhe NDI.

Nazane Breca- Tha se unë, për shkaqe shëndetësore, tërhiqem nga grupi punues për Projektligjin për Organizimin Sindikal dhe propozoj që në vendin tim të jetë Time Kadriaj, si anëtare e këtij grupi punues.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka